



S T A T U T

i

SHOQERISE "A.Bi Esse"

Shoqeria tregtare me perjegjesi te kufizuar "A.Bi Esse" u krijua ne baze te kontrates per krijimin e saj midis ortakeve:

1. Giuseppe Sarvia, i biri i Giacomoos dhe Maries, lindur me 17.07.1956 ne Fossano, banues ne via Chiarini N. 10, CAP 12045, FOSSANO (CN) ITALIA, me pasaporte N. 750619 G.
2. Luigi Trigari, i biri i Alessandros dhe Pasqualines, lindur me 28.05.1955 ne Fossano, banues ne via Lancimano N. 30, CAP 12045, FOSSANO (CN) ITALIA, me pasaporte N. 888096 M.
3. Riko Pilika, i biri i Nikos dhe Elenit, lindur me 06.11.1941 ne Tirane, banues ne rruga Hoxhe Vokrri P.19/1 Ap.3, TIRANE SHQIPERI, me pasaporte N. 092709.
4. Robert Dako, i biri i Aleksandrit dhe Rozit, nato il 18.10.1944 ne Tirane, banues ne rruga Tefta Tashko P.22/1 Shk.1 Ap.1, TIRANE SHQIPERI, me pasaporte N. 061750.

Per te bere te mundur aktivitetin ekonomik dhe organizimin e kesaj shoqerie ne mbeshtetje te ligjt n. 7638 dt. 19.11.1992 dhe te ligjt n. 7667 dt. 28.01.1993, pjeset mblidhen per hartimin e ketij statuti, i cili u formua konform ligjt per " Shoqerite Tregtare " me perjegjesi te kufizuar.

KAPITULLI I PARE

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

(Formimi, emertimi, objekti, kohezgjatja)

Art. 1

Midis ortakeve te siperpermendur u formua shoqeria me perjegjesi te kufizuar me emrin " A.Bi Esse " sipas aktit te themelimit, me seli ne Tirane, ne rrugen Tefta Tashko P.22/1 Shk.1 Ap.1.

Art. 2

Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj:

- Prodhimin, perpunimin dhe transformimin e cdo artikulli te kerkuar nga tregu i brendshem ose i jashtem (industrial, ushqimor, etj).

- Tregtimin me shumice dhe pakice te cdo artikulli te kerkuar nga tregu.

~~- Aktivitet imoort-eksporti per vete ose per te tretet.~~

~~- Pjese marrje direkte ose indirekte ne investime ne fushen e ndertimit, turizmit, transportit, lendeve djegese, bujqesise, prodhimit dhe sherbimit.~~

~~- Teknike te gjitha operacionet, me pasuri te tundshme e te patundshme, financiare qe mund te perfshire dorezani, dhene garancie ne per gjithesi, perfshire ato reale ne favor te vet apo te te treteve. (Ajo mund te bleje, te shese, te jape me qira, te administroje ose te jape ne administrim prona te ndryshme te tundshme dhe te patundshme).~~

- Operacione bancare dhe financiare ne te gjitha fushat.

- Konsulence teknike, juridike, ekonomike dhe financiare per investitore shqiptare dhe te huaj.

- Shoqeria mund te bashkepunoje me shoqeri te tjera qe kane te njejtat qellime ose qe kane lidhje me objektin e saj.

- Ajo mund te beje te gjitha ato veprime qe i duken te arsyeshme per zhvillimin e aktivitetit te saj.

Art. 3

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jetë 30 vjet.

Art. 4

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Lek, nga te kater ortaket.

Kapitali baze eshte i ndare ne 100 pjesa te barabarta me viene 1.000 Lek secila.

Kontributi i secilit ortak eshte i percaktuar si vijon:

1. Giuseppe Sarvia 25%
2. Luigi Trigari 25%
3. Riko Filika 25%
4. Robert Dako 25%

Art. 5

Ndarja e fitmit do te behet sipas kontributit te secilit ortak.

Ne rast te rritjes se kapitalit baze me shtimin e pjesave te reja, ortaket kane te drejten e pronesise dhe avantazhet mbi pronesine, ne perpjeksim me kuoten e tyre ne kapitalin baze.

Rritja e kapitalit vendoset nga Asemblea e Ortakeve, ku marrin pjesa te gjithe ortaket e shoqerise, ose te perfaqesuan nga nje person i autorizuar prej tyre.

Art. 6

Kuotat janë të transferueshmë me shkresa midis të gjallive, me aprovimin e shumicës se ortakeve. E drejta e parablerjes është e reservuar për ortaket. Ortaku që deshiron të tjetersojë kuoten e vet duhet t'u komunikojë ortakeve të tjere me letër të porositur, e cila duhet të përbaje kushtet e shitjes, çmimin dhe gjenerositet e bleresit. Ortaku që deshiron të ushtroje të drejtën e parablerjes duhet t'u komunikojë ortakeve të tjere dhe duhet të bëje blerjen me kushtet e propozimit 30 dite nga marrja e duhet tij. Kur disa ortake deshironin të ushtrojnë të drejtën e parablerjes, kuotat ndahen ndërmjet pretendentave ne perpjessatim me kuoten që ka secili.

Art. 7

Kuotat e kapitalit janë të transferueshmë lirisht me trashëgimi.

KAPITULLI I DYTE

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Art. 8

Organi vendimor i shoqerise është Asemblea e Ortakeve. Cdo Ortak merr pjesë në vendimet e asemblese dhe disponon një numer votash të barabarte me pjesen e kapitalit baze që zoteron.

Një ortak mund te ngarkoje një person tjetër te votoje në emrin të tij per një pjesë të kapitalit baze duke votuar vete per pjesen tjetër të kapitalit baze.

Asemblea mund te mblidhet me kërkesën e cdo ortaku, nga administratorët, ose nga likuiduesi.

Art. 9

Mbledhjet e Asemblese mund te jene të zakonshme dhe të jashtezakonshme, sipas rendesise se vendimeve. Asemblete e zakonshme vendosin me shumicë votash për çështje si emertimi ose pushimi nga puna i administratorëve të jashtem, i eksperenteve kontabel të autorizuar dhe i likuiduesve, aprovimi i raporteve të administrimit, ndarjes se fitimit, etj.

Asemblete e jashtezakonshme vendosin për çështje si ndryshimet në statut, rritja ose pakesimi i kapitalit baze, transferimi i pjesave të kapitalit baze të tretave, rritja e kohezgjatjes se aktivitetit të shoqerise, ose likuidimi i saj, ndryshimi i llojit të shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi të kufizuar, ne një formë të shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi të kufizuar, ne formen e kerkuar nga ligji.

Art. 10

Vendimet e Asembleje, qofte e zakonshme ose e jashtezakonshme, te marrja konform ligjit, aktit te themelimit dhe statutit te kesaj shoqerie, si dhe akteve te tjera te shoqerise, jane te detyrueshme per te gjithe ortaket edhe kur nuk jane te pranishem ose nuk jane dakort.

Art. 11

Asemblea, qofte e zakonshme ose e jashtezakonshme, mblidhet nga organi administrativ nepermjet nje letre te porositur me lajmerim marrje se cila permban vendin, diten dhe oren e mbledhjes si dhe regjistro e dites. Letra duhet tu dergohet ortakeve te pakten tete dite perpara mbledhjes, ne vendbanimin e tyre. Lajmerimi mund te permbaje edhe diten e mbledhjes se dyte te mundshme. Asemblea mund te mblidhet edhe jashte sësise se saj. Asemblete do te quhen te rregullta edhe ne mungese te lajmerimit formal, kur te jetë i pranishem ose i perfakesuar i gjithe kapitali i shoqerise dhe te jene te pranishem te gjithe administratoret dhe revisorët, kur jane te emeruar.

Art. 12

Asemblete e zakonshme mblichen te pakten nje here ne vit per aprovimin e bilancit, gjashte muaj nga mbyllja e periudhes ushtrimore. Ne asemble kane te drejte te marrin pjesa te gjithe ortaket e rregjistruar ne librin e ortakeve perpara datës se mbledhjes. Odo ortak mund te perfadesohet me mandat, i cili do te mbetet ne aktet e shoqerise, por gjithmonë brenda limiteve te përgjikuara nga ligji.

Aktet e shoqerise nuk mund te perfakesoje me shume se dy te tjere, ciladecja qofte shkalla e pjesemarrjes se tij ne shoqeri.

Art. 13

Shoqeria administrohet nga administratori i vetem Raf Pili. Administratori ka te gjitha kompetencat te kryeje, perballje te treteve, te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe per llogari te saj, qe perputhen me objektin e shoqerise, perves atyre qe per kete statut dhe per ligji jane kompetence e Asembleje se Ortakeve.

Asemblea e Ortakeve vendos kompetencat dhe detyrat e administratorit.

Administratori eshte personalisht pengjegjes sipas statutit, perballje shoqerise dhe perballje te treteve, per shkeljen e statutit ose per krimet te tjera te kryera gjate administrimit te shoqerise prej tij.

Kontrolli i shoqerise behet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vjet nresht, i rizgiedhshem. Ai zgjidhet nga mbledhja e asembleje.

Pushimi nga puna i eksperteve kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita te emerimit te tyre, ne rast kur vihen re gabime ne punen e tyre, gje qe ben te pamundur kryerjen e punes.

Art. 14

Per punetoret qe do te punesohen ne kete shoderi aplikohen te gjitha aktet ligjore dhe nenligjore te nxjerra per kete qellim, duke bere kontrata pune me seculin prej tyre per nje periudhe kohe te caktuan. Paga e punes nuk ka kufi, por nuk mund te jete me e vogelise ajo e vendosur nga Vendimet specifice te Keshillit te Ministrave.

KAPITULLI I TRETE

RELATAT EKONOMIKO-FINANCIARE

Art. 15

Viti finanziar fillon me i janar te cdo viti dhe mbaron me 31 dhjetor, me perjashtim te vitit te pare te aktivitetit.

Llogaritjet vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit finanziar, dhe reportet e vecanta te administratorit dhe eventualisht te ekspertit kontabel te autorizuar, aprovohen nga Asemblea e Ortakeve.

Art. 16

Aprovimi i bilancit dhe dokumentacionit te aktivitetit vjetor behet brenda muajit mars te vitit pasardhes.

Pas aprovimit te llogarive vjetore dhe pasi shihet qe ekziston fitimi, Asemblea e Ortakeve vendos pjesen qe i perket seculit ortak ne formen e ndarjes se fitimit.

Fitimi qe do t'i ndahet ortakeve ne perpjestim me pjeset qe perbejne kapitalin baze, eshte i perbere nga fitimi i vitit finanziar, te cilit i hiqet shuma e lene me nje ane per fondin e rezerves se domosdoshme, gjithashtu i shtohen ose i hiqen fitimet ose humbjet e viteve te meparshme.

Llogarite ekonomike dhe ato kontabel regjistrohen ne LEK ose ne valute.

Aktiviteti ekonomik regjistrohet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim dhe bazohet ne aktivin ose pasivin qe pasqyrohet detyrimit ne bilancet e plotesuara nga ekspertet kontabel, te cilet jane pergjegjes para ligjit per punen e tyre.

Art. 17

Shoqeria, me qellim qe te lehtesoje dhe te beje me te shpejte pagimin e te treteve, do te hape ne nje banke, shqiptare ose te huaj, te njoftur nga shteti shqiptar, nje illogari rrjedhese.

KAPITULLI I KATERT

SHFERNDARJA DHE LIKUIDIMI

Art. 18

Ne perfundim te kohes se parashikuari ne kontraten themeluese te shoqerise, shtyrja e afatit behet vetem me vendim te Asemblee se Ortakeve.

Shoqeria nuk shperndahet kur nje nga ortaket falimenton, behet i paaftë ose vdes. Ajo shperndahet kur mbaron afati i parashikuari dhe ortaket nuk bien dakort per shtyrjen.

Shoqeria mund te nderrohet ne nje tip tjeter shoqerie te parashikuari nga ligji, ne formen e kerkuar nga ligji.

Shoqeria mund te shperndahet edhe me vendim te gjykates, kur ekzistojne motive gjyqesore.

Art. 19

Shoqeria hyn ne likuidim nga momenti qe vendoset shferndarja e saj. Per fillimin e ketij operacioni Asemblea e Ortakeve emeron nje likuidues, i cili prezanton raportin e likuidimit, gjendjen e aktivitet ose pasivit te shoqerise, proceduren e operacionit te likuidimit dhe kohen e nevojshme per mbylljen e tyre.

Ne fund te operacionit te likuidimit, Asemblea vendos me shumice votash bilancin perfundimtar mbi mbylljen dhe likuidimin e shoqerise.

Pas pageses se kreditoreve dhe pas shferndarjes se kapitalit baze cdo ortaku, likuiduesi ndan midis ortakeve kapitalin e mbetur, ne perpjestim me kuoten qe ka secili ne kete kapital.

Art. 20

Te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin nga ekzekutimi i ketij statuti dhe i aktit te themelimit gjate ekzistences se shoqerise, gjate zhvillimit te aktivitetit, apo gjate likuidimit, qe nuk do te zgjidhen me mirekuptim midis paleve, do t'i kalojne per gjiqim Gjykates se Rrethit Tiranës.

Art. 21

Ne te njejtën menyre do te zgjidhen edhe moskuptimet midis punonjesve te punesar ne kete shoqeri dhe vete Shoqerise ose ne

relatat me të tretet, përvetë rasteve kur në kontrate parashikohet ndryshe.

URDHERESA TE PERGJITHSHME

Art. 22

Per sa nuk parashikohet qarte në këtë statut, do t'i referohet Kodit Civil dhe ligjit mbi "Shoqerite Tregtare", si dhe ligjeve të tjera të kesaj fushe.




Art. 23

Ky statut shtypet në pese kopie, të cilat do t'i shperndahen organeve kompetente, ndersa njera do të qendroje pjese përbërëse e dokumentacionit të kesaj shoqerie.

Statuti u lexua, dhe pasi u gjet konform vullnetit të piseve, u nenschkrua prej tyre.

P R O N A R E T

1.Giuseppe Sarvia 2.Luigi Trigari 3.Riko Pilika 4.Robert Dako



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 7415 rep
Nr. 3940 kol

V E R T E T I M

Vertetohet se sot, me date 14. 08. 1995 u paraqiten në Zyren e Noterise se Tiranes zoterinjte Giuseppe Sarvia, Luigi Trigari, Riko Pilika, Robert Dako, ne moshe madhore, me fuqi të plota juridike për të vepruar, të cilet me deklaruau qe nenschkruan statutin e siperpermendur me vullnet të plote. Une, noteri, pasi u sigurova per identitetin e tyre nepermjet pasaportave personale, vertetoj nenschkrimin e tyre.



N O T E R E

Shpresa Kurti

